LIGJ
Nr.9835, datë 22.11.2007

PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR.8215, DATË 9.5.1997 "PËR KONTROLLIN FINANCIAR TË PERSONAVE JURIDIKË JOBANKARË, QË KANË MARRË HUA NGA PUBLIKU I GJERË", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.8215, datë 9.5.1997 "Për kontrollin financiar të personave juridikë jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë", të ndryshuar, në nenin 2 paragrafi i parë, fjalët "pranë Këshillit të Ministrave" zëvendësohen me fjalët "në varësi të Ministrit të Financave".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5531, datë 4.12.2007 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Bamir Topi